

RAPORTI I TË DREJTAVE TË NJERIUT – MAQEDONIA E VERIUT 2019

REZYME EKZEKUTIVE

Republika e Maqedonisë së Veriut është demokraci parlamentare. Presidenti i zgjedhur nga qytetarët është udhëheqës i shtetit dhe komandant suprem i forcave të armatosura. Parlamenti njëdhomësh ushtron pushtetin ligjvënës. Në vitin 2016 u mbajtën zgjedhjet parlamentare ndërkaq ato presidenciale u mbajtën gjatë vitit. Në raportin përfundimtar për zgjedhjet parlamentare, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE / ODIHR) ka deklaruar se zgjedhjet kanë qenë transparente, janë administruar mirë dhe në mënyrën e duhur, por u zhvilluan në "rrethana ku mungonte besimi publik në institucionet dhe në establishmentin politik" dhe dështuan në përmbushjen e disa detyrimeve të rëndësishme të OSBE-së, për një proces demokratik zgjedhor. Raporti përfundimtar i OSBE / ODIHR mbi zgjedhjet presidenciale të vitit 2014 vuri në dukje se zgjedhjet respektonin liritë themelore të qytetarëve, por se nuk kishte ndarje të mjaftueshme midis veprimtarisë partiake dhe shtetërore.

Policia kombëtare ruan sigurinë e brendshme, përfshirë migracionin dhe menaxhimin e kufirit, dhe i raporton Ministrisë së Brendshme. Autoritetet civile kanë ruajtur kontrollin efektiv mbi forcat e sigurisë.

Çështje të rëndësishme të të drejtave të njeriut përfshinin: korrupsionin e nivelit të lartë dhe dhunën ndaj personave LGBTI.

Qeveria gjithashtu bëri hapa për të hetuar, ndjekur dhe dënuar zyrtarët që kanë bërë abuzime. Avokati i Popullit beson se mosndëshkimi i policisë vazhdoi të ishte një problem.

Pjesa 1. Respekt për integritetin e personit, përfshirë edhe lirinë nga:

a. Privimi arbitrar nga jeta ose vrasje të tjera të paligjshme ose për motive politike

Nuk ka pasur raporte që Qeveria ose përfaqësuesit e saj të kenë kryer vrasje arbitrare ose të paligjshme.

b. Zhdukja

Nuk ka pasur raporte zhdukjesh, nga ose në emër të autoriteteve qeveritare.

c. Tortura dhe trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese

Kushtetuta dhe ligji i ndalon këto praktika, por ka pasur disa raporte sipas të cilave policia ka abuzuar me të ndaluarit dhe të burgosurit dhe ka ushtruar forcë të tepërt. Qeveria ka vepruar për të hetuar dhe për të ndjekur pretendime legjitime. Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale (SSP) pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme ka raportuar se gjatë shtatë muajve të parë të vitit, ka vepruar në lidhje me 27 ankesa për ushtrim të forcës së tepërt nga efektivi policorë. Tetë nga këto ankesa u shpallën të pabaza dhe vetëm një u pranua.

Kushtet e burgjeve dhe qendrave të paraburgimit

U morën hapa të dukshëm për të përmirësuar kushtet e burgjeve dhe qendrave të paraburgimit që nga raporti i Komitetit të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës (CPT) të tetorit 2017. Bazuar në një vizitë të vitit 2016, Raporti përshkroi kushtet si një trajtim mizor, çnjerëzor dhe degradues.

Kushtet fizike: Vendi ka 11 burgje dhe tre objekte korrektuese për të mitur; në shtatë nga burgjet janë vendosur edhe të paraburgosur në pritje të gjykimit. Të burgosurit e mitur mbahen në mjedise të ndara.

Sipas Ministrisë së Drejtësisë dhe Avokatit të Popullit, mbipopullimi nuk është më një problem i rëndësishëm, megjithëse sistemi i burgjeve vazhdoi të vuante nga mungesa e fondeve dhe stafit. Sipas informacionit zyrtar nga Ministria e Drejtësisë, deri më 3 shtator, kanë qenë 1.879 të burgosur, ndërsa burgjet kanë kapacitetin për të strehuar 2.026 të burgosur.

Më 29 maj, Komisioni Evropian (KE) lëshoi raportin e tij të vitit 2019 mbi vendin, i cili vuri në dukje se qeveria kishte adresuar rekomandimet e KPT-së, duke çuar në përmirësime në parandalimin e torturave dhe keqtrajtimit. Kushtet e këqija në stacionet e policisë, qendrat e kujdesit social dhe institucionet psikiatrike vazhdojnë të paraqesin problem.

Avokati i Popullit raportoi më 13 shtator se burgju dhe ambientet e paraburgimit mbeten nën standardet ndërkombëtare, duke përmendur kujdesin joadekuat shëndetësor dhe kushtet përgjithësisht të këqija të jetesës, si mangësitë e raportuara më shpesh. Strehimi i dobët dhe mungesa e shërbimeve të përshtatshme rehabilituese në Burgun e Ohrit vazhduan t'i vinin të burgosurit e mitur në rrezik të shtuar nga dhuna dhe shfrytëzimi. Shtatë vdekje ishin regjistruar në të gjitha burgjet

deri më 13 gusht. Njëri u raportua si vetëvrasje dhe gjashtë vdiqën për shkaqe të tjera.

Ministria e Drejtësisë, Departamenti për Zbatimin e Sanksioneve mori 18 njoftime të brendshme për përdorimin e forcës ndaj të burgosurve nga policia e burgut. Në të gjitha rastet, departamenti kishte konstatuar se nëpunësit kishin vepruar në përputhje me Procedurat Standarde të Operacionit. Ka pasur një denoncim të jashtëm të përdorimit të forcës nga policia ndaj një të burgosuri, nga familja e të burgosurit. Drejtoria për Zbatimin e Sanksioneve gjeti parregullsi në veprimet e policit të burgut dhe ia referoi ankesën Komisionit disiplinor të burgut, i cili nuk gjeti asnjë gabim në veprimin e oficerit.

Mekanizmi Kombëtar Parandalues i Ombudsmanit gjithashtu pranoi ankesa kundër rojeve të Burgut të Ohrit për keqtrajtim dhe torturë ndaj të burgosurve të mitur. Nuk kishte asnjë informacion nëse këto ankesa ishin hetuar.

Përveç hetimit të çdo pretendimi për keqtrajtim policor, Sektori i Standardeve Profesionale i Ministrisë së Brendshme kreu të gjitha hetimet e brendshme për pretendimet e formave të tjera të sjelljes së keqe të policisë. Sektori ka autorizim të shqiptojë sanksione administrative, si pezullim i përkohshëm nga puna, gjatë zhvillimit të hetimeve. Sektori nuk mund të ndërmarrë masa disiplinore, të cilat kërkojnë një vendim nga një komision disiplinor, as nuk mund të vendosë sanksione më serioze penale, të cilat kërkojnë masa gjyqësore.

Autoritetet e Ministrisë së Drejtësisë vazhduan të shpërndanin në burgje broshurat e përgatitura me ndihmën e OSBE-së duke u shpjeguar të burgosurve se si të paraqesin ankesa anonime te Avokati i Popullit në lidhje me keqtrajtimin.

Administrata: Raporti i Avokatit të popullit të vitit 2018 ka regjistruar vetëm disa ankesa nga të burgosurit për sjellje joprofesionale dhe dhunë nga personeli i sigurisë.

Autoritetet kanë shqyrtuar ankesat dhe kanë kryer hetime të pretendimeve të besueshme të keqtrajtimit. Deri më 13 shtator, Avokati i Popullit kishte marrë katër ankesa që kishin të bënin me dhunën në burg. Prej tyre, dy ankesa në të cilat kishte pretendime për keqtrajtim nga rojet e burgut, u hodhën poshtë si të pabaza dhe një veprim disiplinor kundër një roje burgu ishte në pritje. Ankesa e katërt kishte të bëjë me një grup rojesh të burgut, të cilët iu nënshtruan procedurës disiplinore për mosveprim për të parandaluar një sulm të një të burgosuri.

Numri i të burgosurve pa dokumente të vlefshme identifikimi shënoi ulje. Në vitin 2017 kishte 900 të burgosur pa karta identiteti; në tetor më pak se 285 ishin pa dokumente të vlefshme identiteti.

Monitorim i pavarur: Ligji lejon mjekët, përfaqësuesit diplomatikë dhe përfaqësuesit nga KPT-ja dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq të kenë qasje te personat në paraburgim me miratimin e gjyqtarit hetues.

Bazuar në një memorandum mirëkuptimi të nëntorit 2018, Qeveria i dha Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut qasje të pakufizuar te të burgosurit e dënuar. Avokati i Popullit vizitoi rregullisht (një herë në muaj) burgjet e vendit dhe hetoi pretendimet e besueshme për kushtet problematike.

Përmirësimet: Gjatë vitit, objektet e braktisura në burgun më të madh të Idrizovës, u rrënuan dhe burgu i Manastirit u mbyll për rindërtim të plotë për shkak të kushteve të këqija të jetesës.

Që nga qershori, të gjithë të burgosurit kishin sigurim shëndetësor përmes Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve, megjithëse mbeti e hapur çështja e aksesit në kujdesin shëndetësor. Të burgosurit gjithashtu kishin akses në ujë të nxehtë për higjienën personale. Anëtarët e personelit në institucionet penitenciare dhe edukative-korrektuese u trajnuan lidhur me *Kodin e ri të sjelljes për personelin e burgjeve*, bazuar në *Kodin Evropian të Etikës për Personelin e Burgjeve*.

d. Arrestimi ose paraburgimi arbitrar

Ligji ndalon arrestimin dhe paraburgimin arbitrar dhe parashikon të drejtën e çdo personi për të kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit ose paraburgimit të tij në gjykatë. Qeveria në përgjithësi i ka respektuar këto kërkesa.

Procedurat e arrestimit dhe trajtimi i të ndaluarve

Ligji parasheh që gjyqtari të lëshojë urdhër për arrestimin dhe ndalim të të dyshuarve bazuar në prova, dhe policia në përgjithësi ka ndjekur këtë dispozitë. Ligji parasheh që personi i ndaluar të paraqitet para prokurorit në afat prej 24 orëve pas arrestimit. Gjyqtari i procedurës paragjyqësore, me kërkesë të prokurorit mund të urdhërojë ndalimin e të dyshuarit deri në 72 orë para daljes në gjyq. Në përgjithësi, policia u është përmbajtur këtyre procedurave.

Autoritetet në përgjithësi kanë informuar të ndaluarit menjëherë për akuzat kundër tyre. Paraburgimi para ngritjes së padisë mund të zgjasë më së shumti 180 ditë. Pas aktakuzës, paraburgimi mund të zgjasë maksimumi dy vjet.

Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, Avokati i Popullit ka pranuar tre ankesa për keqtrajtim të personave të ndaluar, dy nga zyrtarët e burgut dhe një nga të arrestuarit e tjerë. Në rastet ku kishte pretendime nga të burgosurit e tjerë, u shqiptuan masa disiplinore kundër disa nëpunësve të burgut për dështim në kryerjen e detyrave të tyre. Në rastin e dy nëpunësve të burgut, pretendimet u shpallën si të pabaza. Ministria e Brendshme SSP pranoi katër për përdorimin e tepruar të forcës gjatë marrjes në pyetje të të dyshuarve dhe të paraburgosurve. SSP ka ngritur padi penale kundër një efektiv policie për trajtim të papërshtatshëm policor dhe ka hedhur poshtë tre të tjerët për shkak të mungesës së provave

Ekziston sistem funksional i dorëzaniës. Ligji i lejon të pandehurit të komunikojë me një avokat të zgjedhur prej tyre, por autoritetet nuk kanë informuar gjithmonë të ndaluarit ashtu siç duhet për të drejtën e tyre dhe nuk kanë lejuar gjithmonë që të konsultohen me një avokat para paraqitjes në gjykatë. Të ndaluarit e varfër kanë të drejtë të kenë avokat në llogari të shtetit, dhe autoritetet në përgjithësi e kanë respektuar këtë të drejtë. Gjyqtarët zakonisht u kanë dhënë leje avokatëve për të vizituar klientët e tyre në paraburgim. Vendi nuk e ka praktikuar paraburgimin pa njoftim.

Përveç hetimit të çdo pretendimi për keqtrajtim policor, Sektori i Standardeve Profesionale i Ministrisë së Brendshme kreu të gjitha hetimet e brendshme për pretendimet e formave të tjera të sjelljes së keqe të policisë. Sektori ka autorizim të shqiptojë sanksione administrative, si pezullim i përkohshëm nga puna, gjatë zhvillimit të hetimeve. Sektori nuk mund të ndërmarrë masa disiplinore, të cilat kërkojnë një vendim nga një komision disiplinor, as nuk mund të vendosë sanksione më serioze penale, të cilat kërkojnë masa gjyqësore.

Paraburgim në pritje të gjykimit: Në shumicën e rasteve, gjykatat kanë respektuar ligjin për procedurat e paraburgimit. Gjatë vitit, numri i urdhrave të gjykatës për paraburgim ishte rritur lehtë krahasuar me 2018, kryesisht në rastet e ngritura nga Prokuroria e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit dhe Prokuroria Themelore e Shkupit. Prokurorët në të gjithë vendin kishin kërkuar paraburgim në 5 deri në 10 për qind të të gjitha rasteve. Zakonisht, prokurorët kishin kërkuar, dhe gjykatat kishin vendosur masa parandaluese në vend të urdhrave për paraburgim të të dyshuarve dhe të pandehurve për të parandaluar rrezikun e ikjes së dëshmitarëve, manipulimit të provave dhe përsëritjen ose kryerjen e krimeve të reja.

e. Mohimi i gjykimit të drejtë publik

Kushtetuta parashikon gjykata "autonome dhe të pavarura", të mbështetura nga

Këshilli Gjyqësor i pavarur dhe autonom. Pavarësia e kufizuar gjyqësore, politizimi i organit mbikëqyrës gjyqësor dhe financimi i pamjaftueshëm i gjyqësorit, megjithatë, kanë vazhduar të pengojnë operacionet gjyqësore dhe efektivitetin.

Qeveria ka demonstruar respekt më të madh për pavarësinë dhe paanësinë e gjyqësorit krahasuar me vitet e mëparshme. Sipas raportit të KE-së të 29 majit, sistemi gjyqësor i vendit ka bërë përparim të mirë në adresimin e "Prioriteteve Urgjente të Reformave të kërkuara nga BE" dhe rekomandimeve nga Komisioni i Venecias dhe Grupi i Ekspertëve të Lartë për Çështjet Sistemike të Sundimit të Ligjit. Vendi ka demonstruar vendosmëri të vazhdueshme për të përmirësuar sistemin gjyqësor, duke shqiptuar vendime për disa çështje të profilit të lartë të Prokurorisë Speciale.

Sipas OSHC-ve të specializuara për sundimin e ligjit "Të Gjithë për Gjykime të Drejta", vendimet në 20 gjykimet të Prokurorisë Speciale Publike (PSP) për shkak të vonesave të ndryshme procedurale mesatarisht kanë zgjatur më shumë në krahasim me rastet e zyrave të tjera të prokurorisë. Nga 20 rastet e PSP-së në pritje në gjykatat që nga 30 qershori 2017, vetëm dy kanë përfunduar me vendime gjyqësore që nga 1 nëntori.

Qytetarët kishin paraqitur 176 ankesa në lidhje me gjyqësorin nga janari në gusht, sipas Zyrës së Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit kishte ndërmarrë masa në 48 nga ato ankesa, duke rekomanduar një shumëllojshmëri veprimesh korrigjuese dhe gjyqësori ndërmori masa për 20 prej çështjeve.

Midis 1 janarit dhe 31 gusht, Avokati i Popullit veproi si "miku i gjykatës" (të drejtat e njeriut *amicus curiae*) në pesë çështje gjyqësore. Kjo ishte hera e parë që Avokati i Popullit shërbeu si *amicus curiae*, një autoritet i shtuar i parashikuar sipas ndryshimeve të ligjit të vitit 2016.

Ndërsa kishte pasur rregulla të rrepta që rregullonin caktimin e rasteve gjyqësore përmes një sistemi elektronik të menaxhimit të çështjeve, në shtator 2018 Prokuroria Publike e Shkupit kishte thirrur disa persona për intervista pasi një kontroll i vitit 2017 zbuloi se sistemi për caktimin e gjyqësorëve për të trajtuar raste specifike ishte manipuluar. Më 18 qershor, Ministria e Drejtësisë publikoi gjetjet nga inspektimi i Komisionit të Monitorimit të përdorimit të Sistemit të Automatizuar të Menaxhimit të Çështjeve të Gjykatave (ACCMIS) në gjashtë gjykata. Raporti i komisionit kishte arritur në përfundimin se çështjet po u cakttoheshin rastësisht gjyqësorëve përmes ACCMIS, dhe nuk kishte gjetur ndonjë provë për raste të zgjedhura me dorë për gjyqësorë të caktuar. Raporti kishte vënë në dukje disa mangësi, si raste që nuk arkivohen, mungesa e stafit të gjykatës dhe pajisjeve të IT dhe rishikimi joefikas i

Këshillit Gjyqësor të funksionit të gjykatave.

Prokuroria Themelore e Shkupit kishte ngritur padi ndaj ish-kryetarit të gjykatës penale Vladimir Pançevski më 8 korrik për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe Këshilli Gjyqësor kishte pezulluar Pançevskin më 17 korrik, në pritje të përfundimit të gjykimit. Gjyqi ishte planifikuar të fillonte më 21 tetor, por ishte shtyrë.

Më 10 shtator, Këshilli Gjyqësor kishte shkarkuar Kryetarin e Gjykatës Supreme Jovo Vangelovski dhe gjyqtaren e kësaj gjykate, Rahilka Stojkovska, për sjellje të keqe në lidhje me përfshirjen e tyre në vendimin e majit 2017 duke anuluar një urdhër paraburgimi të pazgjidhur kundër një të pandehuri. Vangelovski kishte kryesuar panelin me pesë gjyqtarë që kishte marrë vendimin që lejonte të pandehurin të qëndronte i lirë pasi ai kishte munguar më parë nga vendi për një periudhë dy-mujore. Vangelovski i tha shtypit se do të apelojë vendimin mbi baza procedurale dhe thelbësore.

Procedurat gjyqësore

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe gjyqësori në përgjithësi e ka zbatuar këtë të drejtë.

Ligji prezumon të pandehurit e pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia. Të pandehurit kanë të drejtë të informohen menjëherë dhe hollësisht për akuzat (me interpretim falas sipas nevojës). Në përgjithësi, gjykimet kanë qenë të hapura për publikun. Qytetarët vazhduan të ankohen për praktika të pamjaftueshme të zbatimit civil, duke rezultuar në shkelje të të drejtave të qytetarëve.

Për disa raste penale dhe civile, janë përdorur panele gjyqësore prej tre deri pesë persona, të drejtuar nga një gjyqtar profesionist. Autoritetet nuk i kanë dhënë gjithmonë të pandehurit kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen. Në veçanti, të pandehurit e Prokurorisë Speciale (PSP) janë ankuar se gjykata nuk ka dhënë gjithmonë kohë të mjaftueshme për të përgatitur një mbrojtje të mjaftueshme. Të pandehurit mund të komunikojnë me një avokat të zgjedhur prej tyre ose të kenë një të dhënë me shpenzime publike për të varfrit. Të pandehurit mund t'u bëjnë pyetje dëshmitarëve dhe të paraqesin prova në emër të vet. Autoritetet nuk mund të detyrojnë të pandehurit të dëshmojnë ose të pranojnë fajësinë.

Si prokuroria ashtu dhe të pandehurit kanë të drejtën të parashtrojnë ankesa ndaj aktgjykimeve.

Më 15 mars, Gjykata Penale e Shkupit dënoi 16 të pandehur me burg në çështjen e dhunës në Parlament të 27 Prillit 2017 për "rrezikim terrorist të rendit kushtetues dhe sigurisë". Ish-drejtori i zyrës së sigurisë publike u dënua me 18 vjet burg. Dy të pandehur u liruan. Nga 33 të pandehurit fillestar, gjykata amnistoi 15, bazuar në një ligj për amnisti të miratuar në Parlament në dhjetor 2018. Ligji ofroi amnisti për disa pjesëmarrës në sulmet por jo për ata që kanë kryer dhunë, kanë mbajtur armë ose kanë organizuar incidentin.

Të burgosurit dhe të arrestuarit politikë

Nuk kishte raportime për të burgosur ose të arrestuar politikë.

Procedurat dhe mjetet juridike civile

Qytetarët kanë pasur qasje në gjykata për ngritjen e procedurave me të cilat kërkohet dëmshpërblim për shkeljen e të drejtave të njeriut. Individët mund të iniciojnë procedura për të drejtat e njeriut në gjykatat civile, penale ose administrative, dhe në Gjykatën Kushtetuese, varësisht nga lloji i shkeljes së të drejtave të njeriut dhe nga kryerësi i pretenduar. Individët mund të parashetrojnë edhe ankesa ndaj aktgjykimeve të pavolitshme. Ligji e parasheh të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm dhe kjo është bazë ligjore për ngritjen e procedurave kundër vonesave të tepërta para Gjykatës Supreme. Në përgjithësi, Qeveria i ka respektuar aktgjykimet civile të gjykatave vendase. Individët mund të ankohen për rastet që përfshijnë shkeljet e pretenduara nga shteti të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), pasi të jenë shterur të gjitha mundësitë e brendshme ligjore.

Kthimi i pronës

Qeveria ka ligje dhe mekanizma, ndërsa organizatat joqeveritare (OJQ) dhe grupet e avokimit raportojnë se qeveria ka bërë përparim të konsiderueshëm në zgjidhjen e kërkesave të kohës së Holokaustit për qytetarët e vendit. Qeveria nuk ka ligje ose mekanizma në lidhje me zgjidhjen e pretendimeve të kohës së Holokaustit nga shtetasit e huaj. Kthimi i pronës nga periudha e Holokaustit nuk është më një çështje domethënëse në vend, veçanërisht pas Ligjit të Denacionalizimit të vitit 2000 dhe marrëveshjes së kompensimit të vitit 2007.

Ligji për Denacionalizim i vitit 2000 i akordoi të drejtën e denacionalizimit të pasurisë së konfiskuar pas gushtit të vitit 1944 ish-pronarëve dhe pasardhësve të tyre, në përputhje me dispozitat lidhur me të drejtën e trashëgimit. Ai kërkon që aplikuesit të kenë shtetësinë në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit.

Marrëveshja e kompensimit për vitin 2007 ishte midis Qeverisë, Fondit të Holokaustit dhe Bashkësisë Hebraike mundësoi pagesën prej 21.1 milionë eurosh (24.2 milionë dollarë) midis qershorit 2009 dhe qershorit 2018. Në mars, Organizata Botërore e Kthimit të Hebrenjve (WJRO) u angazhua për të ndihmuar Komunitetin Hebre në identifikimin e kërkuesve legjitim. Qeveria shprehu gatishmërinë për të krijuar një grup pune por nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim deri në shtator.

Grupet e avokimit kanë raportuar se disa shtetas të huaj, që nuk mbulohen nga ligji i vitit 2000, ende kërkonin kthimin. Qytetarët e huaj mund të aplikojnë për kthim në procedurat civile. Vendi është palë në Deklaratën Terezin të vitit 2009.

Bashkësia Islame e Maqedonisë së Veriut (BFI) pretendoi se Qeveria kishte dështuar të siguronte kthimin e duhur dhe në kohë të pronës së konfiskuar gjatë periudhës së Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë. Midis pronës së diskutueshme është Xhamia Husamedin Pasha në Shtip që u nacionalizua më 1955. BFI pohon se Qeveria ndërmori veprime deri në vitin 2019 që parandaluan BFI-në të rimarrë pronësinë e duhur të kompleksit të xhamisë.

Në shtator, një organizatë e vllahëve në Manastir pretendoi se veprimet e ndërmarra në vitin 2016 nga Qeveria e privuan organizatën nga pronësia e saj e ligjshme e Kishës së Shën Konstantinit dhe Elenës, e ndërtuar në 1903. Ata pretenduan se Qeveria kishte transferuar pronësinë e kishës tek Kisha Ortodokse Maqedonase-Kryepeshkopata e Ohrit (KOM-KO), pa miratimin e bashkësisë.

Deri më 31 gusht, Avokati i Popullit kishte pranuar 116 ankesa në lidhje me të drejtat e pronës. Prej tyre, 37 kishin të bënin me denacionalizimin, 35 me pronësinë dhe 20 me zonimin.

f. Ndërhyrje arbitrare në privatësi, familje, shtëpi ose korrespondencë

Ligji i ndalon këto veprime, dhe nuk ka pasur raporte që tregojnë se Qeveria nuk i ka respektuar këto ndalime gjatë vitit.

Gjatë vitit Qeveria ka vazhduar të merret me pasojat e zbulimit të përgjimeve të paligjshme, për të cilat pretendohet se janë kryer vite të tëra brenda ambienteve të DSK-së gjatë Qeverisë të mëparshme nën drejtimin e VMRO-DPMNE-së. Kjo fushatë për herë të parë u raportua nga partia e LSDM-së në atë kohë opozitare, në vitin 2015.

Më 22 maj, Parlamenti miratoi Ligjin mbi Agjencinë e Sigurisë Kombëtare (ASK) duke krijuar një agjenci të re për të zëvendësuar Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK). ASK është e pavarur nga Ministria e Brendshme dhe ka mbikëqyrje parlamentare më të madhe. Ligjet e tjera të reformës në sektorin e sigurisë të miratuar më 22 maj përfshiu Ligjin për Koordinimin e komunitetit të sigurisë dhe zbulimit, si dhe ndryshimet në Ligjin për Përgjimin e Komunikimeve, Ligjin për Punët e Brendshme dhe Ligjin për të Huajt. Agjencia filloi me punë më 1 shtator.

Në prill, PP hapi një hetim rreth asaj nëse një aplikacion celular "Zgjedhjet 2019" i përdorur në fushatën zgjedhore presidenciale mbledhte të dhëna në mënyrë të paligjshme. Deri në shtator hetimi ishte në pritje.

Në vitin 2016, Parlamenti ka ndryshuar Ligjin për mbrojtjen e privatësisë për të ndaluar posedimin, përpunimin dhe publikimin e çdo përmbajtje, duke përfshirë bisedat e përgjuara, me ç'rast shkelet e drejta e privatësisë në lidhje me jetën personale apo familjare. Amendamentet, që hynë në fuqi në korrik, gjithashtu e ndalojnë përdorimin e materialeve të tilla në fushatat zgjedhore apo për qëllime të tjera politike.

Agjencia Teknike Operative (ATO), përgjegjëse për përgjimet e ligjshme në vend, filloi me punë në nëntor 2018. Shërben si lehtësues teknik i operacioneve të përgjimit të ligjshëm të komunikimeve, që punon me buxhetin e tij veçmas nga Ministria e Brendshme. Më 14 mars, kryetari i Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Masave për Përgjimin e Komunikimeve, Emil Dimitriev, deklaroi se komiteti vizitoi ATO dhe "nuk gjeti parregullsi" në punën e Agjencisë.

Pjesa 2. Respektimi i lirive civile, ku përfshihet:

a. Liria e shprehjes, duke përfshirë edhe të shtypit

Kushtetuta e garanton lirinë e fjalës, duke përfshirë edhe të shtypit. Qeveria ka shënuar përparim në respektimin e lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes, por mbetën probleme, përfshirë pavarësinë e dobët të medias, dhunën dhe frikësimin e gazetarëve.

Raporti i KE-së për vendin i 29 majit vuri në dukje se "situata e përgjithshme dhe klima politike për mediat vazhdoi të përmirësohej". Raporti përmendi përpjekjet e rritura të Qeverisë për të mbështetur mediat përmes ndryshimeve në legjislacion dhe

subvencioneve financiare për mediat e shkruara. Raporti gjithashtu nënvizoi që organizatat profesionale e pranuan dialogun e hapur dhe rritjen e transparencës së institucioneve.

Raporti i Freedom House Liria në Botë 2019 deklaroi se "ndërsa media dhe shoqëria civile janë aktive, gazetarët dhe aktivistët përballen me presion dhe frikësim! Raporti vuri në dukje se peizazhi i medias ishte "thellësisht i polarizuar përgjatë linjave politike dhe mediat private shpesh ishin të lidhura me interesa politikë ose të biznesit që ndikuan në përmbajtjen e tyre. Disa shtëpi kritike dhe të pavarura operuan dhe u gjetën kryesisht në internet."

Deri në shtator Qeveria nuk kishte marrë masa për të adresuar një letër të hapur të korrikut 2018 nga palët e interesuara të medias duke shprehur shqetësimin për ndryshimet ligjore në kodin zgjedhor, të prezantuar në të njëjtin muaj, që do të lejonte që paratë e taksapaguesve të përdoren për fushata politike në media komerciale.

Liria e shprehjes: Ligji ndalon gjuhën që nxit urrejtjen nacionale, fetare ose etnike dhe parasheh ndëshkime për shkeljet. Individët mund të kritikojnë Qeverinë publikisht ose privatisht.

Shtypi dhe mediat, përfshirë median në internet: Ndërsa mediet dhe raportimi ka mbetur thellësisht i ndarë përgjatë linjave politike, numri i mediave të pavarura që në mënyrë aktive kanë shprehur haptas vështirime të ndryshme ka vazhduar të rritet. Ligjet që ndalojnë gjuhën e cila nxit urrejtjen nacionale, fetare dhe etnike mbulojnë edhe shtypin dhe mediat elektronike, publikimin e librave, si dhe gazetat dhe revistat në internet.

Në janar u krijua Rrjeti nacional kundër gjuhës së urrejtjes në media, nën drejtimin e Këshillit të Etikës së Mediave dhe me mbështetjen e OSBE-së. Rrjeti përbëhet nga 17 subjekte, duke përfshirë edhe mediat dhe gazetarë, shoqërinë civile, Qeverinë dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm. Në shkurt filloi një fushatë ndërgjegjësimi nën moton, "Respekt, Jo urrejtje". Qeveria i pranoi këto organizata dhe nuk i kufizoi aktivitetet e tyre.

Në dhjetor 2018 dhe në shkurt, Qeveria ndryshoi Ligjin mbi Shërbimet e Mediave Audio dhe Audiovizive (AAVMS). Raporti i KE i majit vuri në dukje se zbatimi i ligjit do të kërkonte "angazhim të fortë politik për të garantuar profesionalizmin, respektimin e parimeve të transparencës, emërimet e bazuara në merita dhe përfaqësimin e drejtë". Përfaqësuesi i OSBE-së për lirinë e medias Harlem Desir

mirëpriti miratimin e ligjit të ndryshuar, duke thënë se ai "tani është në përgjithësi në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për mediat audiovizive".

Ndalohet reklamimi i Qeverisë në kanalet komerciale. Raporti i KE i majit shprehu shqetësimin se ndryshimet ligjore që lejuan financimin publik të fushatës së referendumit të shtatorit 2018 me blerje reklamash mundësuan politizimin e politikave editoriale.

Raporti i KE gjithashtu vuri në dukje se "nevojiten përpjekje të mëtejshme të vetë-rregullimit për të përmirësuar standardet profesionale dhe cilësinë e gazetarisë." Këshilli i Etikës në Media njoftoi se deri në gusht, 78 për qind e ankesave të marra ishin për raporte joetike ose lajme të rreme në portalet o në internet.

Gjykata Penale e Shkupit lëshoi një vërejtje më 5 maj ndaj 1TV për shkelje të rregullave të fushatës dhe të Kodit Zgjedhor gjatë raundit të parë të zgjedhjeve presidenciale në prill, duke vazhduar me reklamat politike përtej afatit ligjor. Më 12 korrik, Gjykata e Apelit e Shkupit la në fuqi verdiktin e shkallës së parë duke lëshuar vërejtje për 1TV për shkeljen.

Dhuna dhe ngacmimi: Ka pasur disa raste të kërcënimeve dhe ngacmimeve të pretenduara ndaj gazetarëve gjatë vitit.

Kreu i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, Mlladen Çadikovski, tha në Konferencën Globale për Lirinë e Medias më 10-11 korrik në Londër se mosndëshkimi për rastet e sulmeve ndaj gazetarëve mbetet një problem i madh dhe pengon lirinë e shprehjes. Sipas Shoqatës së Gazetarëve, Ministria e Brendshme përfundoi të 12 hetimet në pritje për sulmet ndaj gazetarëve që nga viti 2017, por asnjë veprim tjetër nuk u ndërмор përveç në një rast. Më 17 maj, Gjykata Themelore e Shkupit dënoi me kusht anëtarin e VMRO-DPMNE Toni Mihajlovski për kërcënimet kundër gazetarit Branko Triçkovski në qershor 2017.

Raporti i KE-së vuri në dukje se vendi duhet "të vazhdojë t'i kushtojë vëmendje ndjekjes së shpejtë dhe efektive nga autoritetet e zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit të të gjitha rasteve të sulmeve fizike dhe verbale kundër gazetarëve".

Që nga 31 gushti, nuk u raportua asnjë progres në lidhje me hetimin e Zyrës së Prokurorisë Themelore mbi ankesën e ish-kryetarit të SHGM-së Naser Selmani të marsit 2018, për kërcënimet kundër jetës së tij dhe familjes së tij nga një individ i lidhur me partinë Bashkimi Demokratik për Integrim.

Më 16 prill, gazetarët që raportuan për infrastrukturën e dobët në fshatin Haraçinë thanë se kishin marrë kërcënime dhe sulme verbale nga individë që thuhet se kishin lidhje me Kryetaren e Komunës Milikije Halimi. Gazetarët pretenduan se individët i shoqëruan me forcë në ndërtesën e komunës pasi ata refuzuan të fshinin intervistat e tyre të regjistruara.

Në një njoftim për shtypin më 18 prill, Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Mediave Harlem Desir dënoi kërcënimin, duke e quajtur atë një "sulm të hapur ndaj lirisë së medias." Për më tepër, Shoqata e Gazetarëve dhe Agjencia e Shërbimeve të Mediave Audiovizive e dënuan sulmin. Policia nuk hapi një hetim sepse, sipas tyre, gazetarët nuk e kishin denoncuar zyrtarisht rastin në polici. As Prokuroria nuk ngriti hetim.

Më 4 qershor, SHGM dhe Këshilli i Etikës së Mediave (KEM) dënuan ashpër "gjuhën e qartë të urrejtjes" kundër shqiptarëve etnikë gjatë festimit të fitores së Kupës Evropiane të Klubit të hendbollit Vardar, më 3-4 qershor në Shkup. SHGM dhe KEM shprehën shqetësimin se media nuk arriti të dënojë gjuhën e urrejtjes që bën thirrje për dhunë dhe jo tolerancë. Komiteti i Helsinkit, OJQ CIVIL dhe partitë politike etnike shqiptare dënuan gjuhën nxitës, duke bërë thirrje që autorët e krimit të nxirren para drejtësisë.

Censura ose kufizimi i përmbajtjeve: Ka pasur disa raportime sipas të cilave Qeveria ka detyruar gazetarët të vetë-censurohen. Në raportin e saj të 29 majit për vendin, KE ka vënë në dukje se "Nuk kishte përparim në përmirësimin e të drejtave të punës dhe sociale të gazetarëve, që punojnë në kushte pune shumë të këqija. Si pasojë, gazetarët ende praktikojnë vetë censurimin. Negociatat e gjata të udhëhequra nga sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punëtorëve të medias nuk rezultuan me ndonjë marrëveshje kolektive të sindikatës me asnjë media."

Ligjet për shpifje: Personat e shpallur fajtorë për trillime, shpifje dhe gjuhë të ligë janë dënuar sipas gjobave të përcaktuara për shkaktimin e dëmit jomaterial. KE vuri në dukje se "janë ndërmarrë hapa paraprakë për të ulur gjobat për shpifje në një shumë simbolike e cila pritet të përmirësojë ndjenjën e ekuilibrit midis lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së reputacionit".

Zëvendëskryeministri Bujar Osmani i BDI-së njoftoi më 29 janar se partia e tij do të paraqesë padi për shpifje kundër gazetarëve dhe medias për pretendimet se disa zyrtarë të BDI kishin abuzuar me fondin shtetëror pensional. SHGM reagoi më 30 janar, duke u kërkuar politikanëve që të përmbahen nga ngritja e padive për shpifje kundër gazetarëve. Më 7 shkurt, zëdhënësi i KE Maja Kocijançiq vuri në dukje "kërcënimet me pasoja ligjore për mediat për raportimin e tyre", nga aktorët politikë, duke përsëritur rekomandimin e KE në vitin 2018 se vendi duhet të demonstrojë

"tolerancë zero për ngacmimet fizike dhe verbale dhe kërcënime ndaj gazetarëve".

Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë Dragi Rashkovski më 2 korrik paralajmëroi padi për shpifje kundër gazetarëve dhe portaleve mediatike për përhapjen e lajmeve të rreme duke pretenduar se ai ishte përfshirë në mënyrë të paligjshme në një ofertë për blerjen e një sistemi të navigimit ajror. SHGM kritikoi "kërcënimet e drejtpërdrejta" të Rashkovskit ndaj gazetarëve si "presion që mund të rezultojë në 'vetëcensurim'."

Liria e internetit

Qeveria nuk ka kufizuar ose penguar qasjen në internet ose censuruar përmbajtjet në internet. Nuk ka pasur raporte për vëzhgim qeveritar të komunikimeve private online pa autorizim përkatës ligjor.

Liria akademike dhe ngjarjet kulturore

Nuk ka pasur kufizime qeveritare për lirinë akademike apo ngjarjet kulturore.

b. Liria e tubimit dhe shoqërimit paqësor

Ligji e parasheh lirinë e tubimit dhe shoqërimit paqësor dhe Qeveria në përgjithësi i ka respektuara.

c. Liria e besimit fetar

Shikoni *Raportin e Departamentit të Shtetit mbi liritë fetare ndërkombëtare* në [https:// www.state.gov/religiousfreedomreport/](https://www.state.gov/religiousfreedomreport/) .

d. Liria e lëvizjes

Ligji parashikon lirinë e lëvizjes së brendshme, udhëtimet jashtë vendit, emigrimin dhe riatdhesimin dhe Qeveria përgjithësisht i ka respektuar këto të drejta.

Një "gjendje krize" ka qenë në fuqi për zonat kufitare me Greqinë dhe Serbinë që nga gushti i vitit 2015. Çdo gjashtë muaj Qeveria e ka zgjatur atë deri në fund të vitit. Gjendja e krizës lejon autoritetet qeveritare të rregullojnë hyrjen dhe transitin e emigrantëve në vend. Që nga mbyllja e "Rrugës së Ballkanit Perëndimor" në 2016, migrantët e kapur në këto zona janë vendosur rregullisht në qendrat e përkohshme të transitit, pranë kufirit, dhe janë kthyer në vendin e mëparshëm të transitit brenda disa ditësh. Nuk u siguroa liri e lëvizjes për migrantët ndërsa ishin në qendrat transite ose në qendrën e pritjes për të huajt e kontrabanduar, as nuk u krijua një procedurë

zyrtare largimi ose ripranimi.

Lëvizja në vend: Zyra e Komisionerit të Lartë të KB për Refugjatët (UNHCR) ka vlerësuar se rreth 25.000 persona kanë tranzituar në vend nga 1 janar - 31 gusht, por as UNHCR dhe as Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) nuk kanë regjistruar ndonjë vepër urrejtje kundër tyre. UNHCR nuk ka vërejtur ndonjë kufizim të lëvizjes brenda vendit për personat e zhvendosur (PZHV), refugjatët ose personat pa shtetësi.

e. Personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV)

Sipas Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (MPPS), 112 persona (26 familje) kanë mbetur të zhvendosur që nga konflikti i brendshëm i armatosur në vitin 2001, shtatë (tre familje) kanë jetuar në qendrat kolektive të banimit, dhe 105 persona (25 familje) kanë qenë në strehim privat ose me familjet pritëse. Qeveria ka ofruar mbrojtje dhe asistencë, dhe ka mbështetur kthimet e sigurta dhe vullnetare, si dhe rivendosjen dhe integrimin lokal të PZHBV-ve. Nuk pati raportime për persona të zhvendosur, viktima të abuzimeve.

Përkundër mungesës së një dokumenti të politikës kombëtare, Qeveria përgjithësisht ka respektuar *Parimet Udhëzuese të OKB-së mbi Zhvendosjen e Brendshme*.

f. Mbrojtja e refugjatëve

Abuzimi i migrantëve, refugjatëve dhe personave pa shtetësi: Qeveria ka bashkëpunuar me UNHCR, IOM dhe organizata të tjera humanitare në sigurimin e mbrojtjes dhe ndihmës për PZHBV-të, refugjatët, refugjatët e kthyer, azilkërkuesit, migrantët, personat pa shtetësi dhe personat e tjerë të prekur.

Autoritetet kanë ndërmarrë masa të rëndësishme për të luftuar dhe zbuluar rastet e kontrabandës së migrantëve. Gjatë vitit Qeveria ka krijuar një grup punues të përbërë nga përfaqësues nga Ministria e Brendshme dhe prokurorë nga Prokuroria Publike për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin. Raporti i KE i majit vuri në dukje problemin e kontrabandës që duhej adresuar vazhdimisht, pasi vendi vazhdonte të ishte nën presion të rëndë për shkak të vendndodhjes së tij gjeografike.

Raporti Vjetor i Komiteti të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut për 2018 ka deklaruar se, "Është mbajtur dispozita që kufizon lirinë e lëvizjes së azilkërkuesve. Gjegjësisht, neni 63 përcakton që liria e lëvizjes do të kufizohet në rrethana të jashtëzakonshme, për të përcaktuar identitetin dhe shtetësinë, dhe për të përcaktuar faktet dhe rrethanat e kërkesave të azilit, veçanërisht nëse është përcaktuar një rrezik për arratisje, në

mënyrë që të mbrohet urdhri dhe siguria kombëtare ose kur një i huaj mbahet për qëllimet e fillimit të një procedure për kthimin ose largimin e tij. "

IOM theksoi se lëvizja e migrantëve përmes rrugës së Ballkanit Perëndimor u lehtësua nga rrjetet e kontrabandës, të cilat i ekspozuan migrantët ndaj rreziqeve të konsiderueshme të abuzimit dhe praktikave shfrytëzuese, përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore.

Ekzistonte një sistem multisektorial dhe procedurat standarde operative (PSO) për të siguruar mbrojtjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore. UNHCR konsideron se sistemi kishte nevojë për forcim dhe një zbatim sistematik të PSO-ve, veçanërisht në lidhje me identifikimin e rasteve.

Dëbimi: UNHCR vlerësoi se aksesit në praktikën e azilit ishte përmirësuar vazhdimisht që nga viti 2016 dhe se shqetësimet e mëparshme në lidhje me praktikën arbitrare të mohimit të qasjes në azil ishin adresuar. Gjatë vitit nuk janë regjistruar raste të kthimit me forcë të azilkërkuesve ose refugjatëve në vendet e pasigurta, ose presion të papërshtatshëm nga ndonjë vend për t'i kthyer ata në vendin e tyre të origjinës.

Qasja ndaj azilit: Ligjet e vendit e parashohin dhënien e azilit ose statusit të refugjatit, ndërkaq Qeveria ka krijuar sistem për dhënien e mbrojtjes për refugjatët. UNHCR ka raportuar se mekanizmi për përcaktimin e statusit të refugjatëve nuk ka siguruar garanci themelore procedurale dhe përcaktim adekuat, siç parashihet me ligj. Ajo ka raportuar se 252 migrantë kanë kërkuar azil në tetë muajt e parë të vitit. Asnjë personi nuk iu dha statusi i refugjatit ose një formë plotësuese e mbrojtjes.

Në prill 2018 Parlamenti miratoi një Ligj të ri mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare dhe të Përkohshme. Shoqata e Avokatëve të Rinj deklaroi se ligji i ri adresonte disa nga mangësitë e ligjit të vjetër që kishin të bënin me të drejtën për ribashkim familjar dhe aksesin në azil, por ai kufizonte padrejtësisht lirinë e lëvizjes së azilkërkuesve. IOM shprehu shqetësime të ngjashme në lidhje me ligjin e ri. Më 14 shtator, Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë parashtresën e Shoqatës në maj 2018 që sfidonte nenet 63 dhe 65 të ligjit.

Qeveria u ka lëshuar dokumente të identifikimit të gjithë refugjatëve të njohur dhe personave tjerë nën mbrojtje subsidiare, por autoritetet shesh kanë vonuar ose nuk ua kanë lëshuar dokumentet e identifikimit azilkërkuesve të rinj.

Migrantëve të ndaluar në Qendrën e Transitit për të Huaj iu penguan qasja në azil. Një kërkesë për azil nga një person i mbajtur në Qendrën e Pritjes për të Huajt (një objekt i tipit të mbyllur në Gazi Babë) do të ishte e mundur vetëm pasi personi të

japë një deklaratë para gjykatës, në procedurë penale, kundër kontrabandistëve të tyre. Gjatë vitit, afërsisht 50 për qind e të gjitha kërkesave për azil të regjistruara në vend u përpunuan përmes Qendrës së Pritjes për të Huajt.

Gjatë vitit, Gjykatat Administrative dhe të Gjykata e Lartë Administrative vazhduan të shmangin vendimet mbi meritat e kërkesave për azil, megjithëse kishin autoritetin e duhur, sipas Shoqatës së Avokatëve të Rinj. Ata i kthyen çështjet në mënyrë rutinore në Ministrinë e Brendshme për shqyrtim të mëtejshëm.

Liria e lëvizjes Sipas UNHCR, autoritetet kanë arrestuar disa individë që i kishin kapur ndërsa ishin kontrabanduar. Arsyet për vendimet e paraburgimit janë arbitrare. Si rregull, personat supozohet të ndalohen derisa të përcaktohet identiteti i tyre. Megjithatë, ata rregullisht janë mbajtur edhe pas identifikimit, për t'i parandaluar që të arratiseshin nga vendi para se të jepnin dëshmi në gjykatë kundër kontrabanduesve. Për më tepër, shumica e azilkërkuesve që ishin paraburgosur më parë kanë raportuar se nuk u ishin lëshuar vendime ndalimi, ose nëse ata merrnin vendime të tilla ishte në një gjuhë që ata nuk mund ta kuptonin, duke i penguar ata të ushtronin të drejtën e tyre për rishikim gjyqësor.

Shoqata e Avokatëve të Rinj (SHAR) gjithashtu vuri në dukje praktikën e ndalimit të migrantëve të paligjshëm dhe azilkërkuesve për të siguruar dëshminë e tyre në procedurat penale të vazhduara gjatë vitit.

Urdhrat e paraburgimit nuk kanë specifikonin bazat ligjore për paraburgim dhe nuk ka pasur asnjë rishikim efektiv gjyqësor të vendimeve të paraburgimit. Sipas SHAR, që nga 28 gushti, të paktën 126 persona janë arrestuar si migrantë të paligjshëm.

Periudha mesatare e ndalimit gjatë vitit ka qenë 15 ditë, me periudhën më të gjatë prej 45 ditë dhe periudhën më të shkurtër prej një ditë.

Është vërejtur një farë përmirësimi krahasuar me vitet e mëparshme, pasi gratë, fëmijët ose familjet në përgjithësi nuk janë ndaluar dhe në vend të kësaj u përdorën masa alternative ndaj paraburgimit. Një Shtëpi e Sigurt, e drejtuar nga një OJQ, është marrë me qira për këta individë, me fonde nga donatorë ndërkombëtarë, kështu që ata nuk u vendosën në burg ose në ambientet e paraburgimit. Sidoqoftë, individët u monitoruan dhe u duhej të paraqiteshin tek autoritetet çdo javë.

Ligji i vitit 2018 për Mbrojtjen Ndërkombëtare dhe të Përkohshme prezantoi mundësinë e ndalimit të azilkërkuesve, referuar në ligj si "kufizim i lirisë së lëvizjes". Sipas kësaj dispozite, tre azilkërkues ishin arrestuar në Qendrën e Pritjes për të Huajt, një objekt i mbyllur. Ligji parasheh se "përdorimi i kufizimit të lirisë së

lëvizjes" duhet të jetë një mundësi e fundit. Ligji nuk parashikon alternativa adekuate ndaj paraburgimit. Gjatë 24 shtatorit, fëmijë të pashoqëruar dhe tre gra ishin mbajtur në paraburgim.

Punësimi: Nuk ka kufizime në mundësinë e refugjatëve për të punuar dhe ligji lejon azilkërkuesit, të cilët nuk kanë përfunduar procedurat e azilit brenda nëntë muajve të aplikojnë për një leje pune.

Ligji i vitit 2018 për Mbrojtjen Ndërkombëtare dhe të Përkohshme gjithashtu siguron të drejtën për të punuar për personat nën mbrojtje subsidiare, si dhe për azilkërkuesit, të cilët nuk kanë përfunduar kërkesën e azilit brenda nëntë muajve. Refugjatët e njohur dhe personat nën mbrojtje subsidiare me leje pune kanë mundësinë të hyjnë në tregun aktiv të punës. Megjithatë, azilkërkuesit u përballën me kufizime për shkak të ligjeve në kundërshtim. Sipas ligjit, një i huaj duhet të ketë një numër unik identifikimi të caktuar në mënyrë që t'i lëshohet një leje pune. Megjithëse një azilkërkues ka të drejtën ligjore të kërkojë një leje pune pas nëntë muajsh në procedurë, ai / ajo nuk ka të drejtë t'i caktohet një numër unik identifikimi, i cili nga i njëjti ligj lëshohet pasi të jepet një vendim pozitiv. Si pasojë, një azilkërkuesi i jepet e drejta për të punuar por nuk është në gjendje ta ushtrojë atë, një boshllëk serioz duke marrë parasysh disa procedura që zgjasin për dy deri në tre vjet, përfshirë rastet e rishikimit gjyqësor.

Qasja në shërbimet themelore: Azilkërkuesit, para një vendimi përfundimtar për kërkesat e tyre për azil, kanë pasur të drejtën e shërbimeve themelore shëndetësore, në përputhje me rregulloret për sigurimin shëndetësor. E njëjta gjë vlen për të drejtën për arsim. Deri më sot, megjithatë, nuk ka pasur raste të fëmijëve që vijnë nga jashtë rajonit të regjistruar në institucionet arsimore shtetërore. Pas njohjes së statusit, personat me status refugjati kanë të drejtën e kujdesit të plotë shëndetësor të ofruar në të njëjtat kushte siç është për qytetarët.

Zgjidhje të qëndrueshme: Sipas UNHCR asnjë nga 394 individët nga konflikti i vitit 1999 në Kosovë që mbetën në vend nuk u kthyen në Kosovë gjatë vitit. Asnjë rast i zhvendosjes nuk ishte regjistruar.

Ligji parashikon natyralizimin e refugjatëve që banojnë në vend nën kushte të preferuara, ndërsa personat nën mbrojtje subsidiare mund të natyralizojnë siç bëjnë të huajt e tjerë që qëndrojnë legalisht në vend për një minimum prej tetë vjetësh. Gjatë vitit, një refugjat dhe një person nën mbrojtje subsidiare u natyralizuan.

Sipas ligjit, MPPS, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe UNHCR, duhet të lehtësojnë kthimin vullnetar të azilkërkuesve në shtëpitë e tyre. Nuk ka pasur raste të riatdhesimit vullnetar të asistuar gjatë vitit.

UNHCR edhe më tej i ka ndihmuar azilkërkuesit nga Kosova të cilët janë refuzuar dhe që u është lejuar të qëndrojnë në vend. Qeveria u ka lëshuar atyre dokumente të përkohshme identifikimi, për t'ua siguruar qasjen deri te shërbimet. MPPS ka siguruar zgjidhje të integruara dhe të qëndrueshme, me mbështetjen e UNHCR-së për rreth 274 refugjatë që kanë aplikuar për integrim në vend. Ministria ka siguruar ndihmë sociale, ndihmë strehimi dhe akses në arsim, kujdes shëndetësor dhe në tregun e punës.

Mbrojtja e përkohshme: Qeveria siguron mbrojtjen shitesë për individët të cilët nuk mund të kualifikohen si refugjatë, por nuk kishte mbrojtje të tilla të dhëna gjatë vitit.

g. Personat pa shtetësi

